



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



07-104/02-13623/25
Kaçanik, 18.06.2025

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik lidhur me Draft-Rregulloren për Transport Publik për territorin e komunës së Kaçanikut, mbajtur me datë 18.06.2025, e Mërkurë, në sallën e Kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 14:00.

Të pranishëm në konsultim publik ishin anëtarët e grupit punues për hartimin e Draft-Rregullores për Transport Publik në komunën e Kaçanikut: Drejtori i DSHPE-së-Ramadush Osmani, Besim Sallahu, Kaltrina Guri.

Nga qytetaret apo grupet e interesit morën pjesë: Shaban Selimi nga El-Travel, Bekim Terziu nga N.T.SH. Beka, Rexhep Saliu nga Raif Saliu B.I, Sadat Krasniqi-Anëtar i Bordit, Ramadan Spahiu- kryesues i Bordit, Nehat Baftiu-Kryesher.

Takimin e udhëheqti Drejtori i DSHPE-së-së Ramadush Osmani.

Procesmbajtëse, Kaltrina Guri, zyrtare ligjore në DSHPE.

Drejtori i DSHPE-së Ramadush Osmani - Përshëndetje për të gjithë, ju falenderoj për pjesmarrje në këtë debat publik lidhur me Draft-Rregulloren për Transport Publik në territorin e Komunës së Kaçanikut. Në këtë draft kemi punuar së bashku me anëtarët e komisionit të cilët janë: Besim Sallahu, Menduh Krasniqi dhe Kaltrina Guri. Ky draft ka qenë i publikuar në web faqen e komunës nga data 04.06.2025, deri më 18.06.2025. Po fillojm me diskutimin.

Disa nene janë të rregullores së kaluar, ajo që mendoj është pjesë kryesore për ta diskutuar janë kushtet për pajisjen me licence dhe leje pune për transport publik të udhëtarëve.

Te neni 13 nga rregullorja e kaluar kemi bërë një lloj ndryshimi ku ka qenë: ti ketë në pronësi 2(dy) autobus, ne duke e parë që realisht edhe ministria nuk e ka këtë kriter që nuk i kërkon 2(dy) autobus kemi menduar dhe është konform me ligjin, pra të ketë vetëm 1(një) autobus për linjë, kurse licenca të lëshohet në vlefshmëri prej 5 viteve, pra në fund të vitit ne bëjmë shpalljen publike për ndarjen e vijave dhe operatorët që ofertojnë në linjen e caktuar, ku kanë me u pajisur me leje pune për 5 vite, pra një pagese bëhet për 5 vite, ndërsa rendin e udhëtimit e miratojmë për 3 vite.

Edhe te kombit kemi ndryshuar, pra jo ti ketë 2(dy) kombi, por 1(një) kombi bus për linjë, kurse licencën për 3 vite.

Te taksit e kemi njejt, ata i vazhdojm për çdo vjet.

E rëndësishme është edhe revokimi i rendit të udhëtimit saktësisht te neni 15, ktu janë arsyet kur i mirret licenca një kompanie. Në këtë rregullore i kemi futur edhe pjesën për stacionin e autobuseve si dhe detyrimet e saj, po ashtu kemi shtuar edhe shërbimin merimangë që nuk ka qenë në rregullore.

Duhet që ra hjekim nenin 86 pika 2, sepse na ka mbetur nga rregullorja e kaluar, e qe nuk duhet të qendroj kjo fjale, pra do ta paraqes ne kuvend dhe e rregullojmë.

Shaban Selimi - a nuk është mundësia që edhe rendin e udhëtimit që të na bëhen 3 vite?

Drejtori I DSHPE-së -Ramadush Osmani: jo, për arsyen se ligji thotë për 3 vite, dhe ne nuk mundemi ta bëjmë në rregullore më shumë se sa e thotë ligji .

Bekim Terziu - te neni 13 pikë b për çdo linjë, si e keni menduar apo si e keni pas fjalën për këtë pikë?

Besim Sallahu - saktësisht për relacion ose për rend të udhëtimit.

Bekim Terziu - sepse psh. në Kaçanik- Stagove ky mundet mi regjistru 30 rende të udhëtimit, e këto një shofer nuk mundet me i mbulu,mos është kjo ndonjë gabim?

Drejtori I DSHPE-së- Ramadush Osmani - idenë ne e kemi kështu relacionin, e jo sa here shkon p.sh në Stagove, por prej neve ka marr p.sh licence për Kaçanik-Stagove dhe anasjelltas, ku për me marr licence duhet me pas (1)një autobus.

Besim Sallahu – p.sh. nëse aplikon për Duraj - Kaçanik ti ke me pas 1(një) autobus.

Ne nuk e kemi llogarit me kilometran, ne e kemi llogaritur me relacion p.sh.Duraj-Kaçanik 1(një) autobus nëse aplikon në fillim të vitit.

Shaban Selimi- p.sh. në qoftëse për fshatin Biçec vjen dikush i fshatit dhe aplikon, ku e keni bërë ju në rregullore me 1 kombi ose 1 autobus?

Besim Sallahu- e kemi ceke që me minibus në terene ku nuk mund të operoj autobusi për shkak të konfiguracionit terenit psh. derisa mund te shkoj autobusi në atë vend, ne aty nuk ja miratojm tjetrit. E kemi menduar edhe këtë qështje, e kemi një nen që përfshihet se për ato nisje kur e merrni psh. Duraj ose Biçec për here të pare e keni një përparësi, ku e shohim nëse e ki intersetin e merrni ju dmth. nëse jo atëher e merr tjetri., e kemi ceke që me kërkesë të banorëve mundet me u shtu një linjë.

Rexhep Saliu - me sa e kuptova te rendi i udhëtimit shtesë, përparësi ka operatori që është duke operuar ose që është duke e mbajtur atë vij nëse e dëshiron, nëse nuk dëshiron e merr apo e mban tjetri.

Drejtori I DSHPE-së Ramadush Osmani - Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim e mbylli takimin publik. Debat i përfundoi në ora 15:40.

Procesmbajtëse
Kaltrina Guri





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Lista e pjesëmarrësve

KONSULTIM PUBLIK ME QYTETARË DHE GRUPET E INTERESIT

TEMA:

DRAFT-RREGULLORE PËR TRANSPORT RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës, Objekti i Administratës komunale

Data dhe koha: 18 Qershor 2025 (e mërkurë), ora 14:00.

Nr.	Emri e mbiemri	Vendbanimi/pozita	Nënshkrimi
1	SHADAK SELIMI	EHL TRAVEL	<i>Shadak Selimi</i>
2	Bekim Ternu	N.F.M. "Balaq"	<i>Bekim Ternu</i>
3	REXHEP DANI	RAIF SHKIV BIL	<i>Rexhep Dani</i>
4	SADAT R.RASNIQI	ANTAR BORDI	<i>Sadat Rasniqi</i>
5	Ramadan Spahiqi	URYESQES BORDI	<i>Ramadan Spahiqi</i>
6	NEHA TIBAFTIU	KRYESHEF	<i>Neha Tibafiu</i>
7	Besim Sallaku	Inspектор Kom.	<i>Besim Sallaku</i>
8	Kaltrina Guri	Zyrtar ligjorestre	<i>Kaltrina Guri</i>
9	Ramadush Omeri	Drejtësia Drejtoria	<i>Ramadush Omeri</i>
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			

Vetëheq: *[Signature]*

18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			

RAMADUSH OSMANI

Drejtor i Drejtorisë së Emefgjencave dhe Shërbimeve Publike

